



2016
RAPORTI VJETOR





”

Tregu i brendshëm i energjisë elektrike u furnizua me 8.46 TWh, nga të cilat 6.35 TWh u prodhuan në vendin tonë dhe 1.82 TWh u importuan nga tregu rajonal i energjisë elektrike. Bilanci energjetik për vitin 2016, e pozicionon Shqipërinë si vend eksportues, me një sasi neto energjie të barabartë me rreth 42 GWh në dalje. Energjia elektrike e transmetuar në rrjetin e transmetimit për vitin 2016 është rreth 8% më shumë se energjia elektrike e transmetuar në vitin 2015.

”

Dr. ENGGJËLL ZEQQO

ADMINISTRATOR I OST SH.A.

Të dashur miq, të nderuar kolegë,

Kam kënaqësinë t'ju paraqes raportin vjetor dhe të ndaj me ju vlerësimin për punën që kemi realizuar përgjatë vitit 2016. Gjatë këtij viti stafi i OST sh.a. është angazhuar maksimalisht për të përmbushur të gjitha detyrat ligjore dhe teknike për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Sistemit të Transmetimit në dobi të të gjithë Sektorit Elektroenergjetik Shqiptar. Edhe këtë vit OST sh.a. ka garantuar performancë të lartë në përmbushjen e detyrimit për transmetimin eficient të energjisë elektrike për tregun e brendshëm, si dhe ka realizuar shkëmbime të energjisë elektrike në tregun rajonal, duke respektuar plotësisht standardet teknike të operimit paralel me sistemin e Zonës së Sinkronizuar të Evropës Kontinentale.

Tregu i brendshëm i energjisë elektrike u furnizua me 8.46 TWh, nga të cilat 6.35 TWh u prodhuan në vendin tonë dhe 1.82 TWh u importuan nga tregu rajonal i energjisë elektrike. Bilanci energjetik për vitin 2016, e pozicionon Shqipërinë si vend eksportues, me një sasi neto energjie të barabartë me rreth 42 GWh në dalje. Energjia elektrike e transmetuar në rrjetin e transmetimit për vitin 2016 është rreth 8% më shumë se energjia elektrike e transmetuar në vitin 2015.

Kujdes i veçantë vazhdon t'i kushtohet realizimit të projekteve madhore për forcimin dhe zgjerimin e sistemit të transmetimit. Rezultatet e arritura në vitin 2016 në përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe besueshmërisë së sistemit, si rrjedhojë e angazhimit tonë maksimal në përputhje me standardet më të mira evropiane dhe ato të ENTSO-E., do të vazhdojnë të ruhen dhe përmirësohen edhe në vitet në vijim, nëpërmjet investimeve dhe projekteve që mbështesin rolin kyç që ka OST sh.a. në zhvillimin dhe operimin e sistemit elektroenergjetik dhe tregut të energjisë elektrike në vend.

Sfidat e së ardhmes, të cilat lidhen ngushtë me përmirësimin e bashkëpunimit rajonal dhe përfshirjen në iniciativa dhe projekte konkrete siç janë: (i) krijimi i tregut të përbashkët elektroenergjetik me Kosovën dhe më gjerë; (ii) bashkërendimi për sigurinë e sistemit elektroenergjetik; (iii) krijimi i tregut të ditës në avancë, etj., dhe të cilat janë pjesë integrale e vizionit tonë për të ardhmen - jam i bindur se nëpërmjet bashkëpunimit dhe me përkushtimin tonë do të arrijmë t'i përmbushim me sukses të plotë duke kontribuar në reformimin e sektorit të energjisë, në nxitjen e ekonomisë dhe në sigurinë dhe qëndrueshmërinë e sistemit elektroenergjetik kombëtar.



PËRMBAJTJA

8

I. Prezantimi i OST sh.a.

13

II. Modeli i drejtimit të OST sh.a.

17

III. Drejtimi operativ i sistemit

29

IV. Shfrytëzimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të transmetimit

37

V. Operatori i tregut

42

VI. Planifikimi dhe zhvillimi i sistemit të transmetimit

48

VII. Pasqyrat financiare



I. PREZANTIMI I OST SH.A.

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Sistemi i Transmetimit të Energjisë Elektrike në Shqipëri drejtohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), një kompani publike me 100% të aksioneve në pronësi të shtetit.

Bazuar në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, OST sh.a. ka përgjegjësinë të operojë, mirëmbajë dhe zhvillojë rrjetin e sistemit të transmetimit, duke përfshirë interkonjeksionet me sistemet e tjera ndërkufitare, për të siguruar aftësinë afatgjatë të sistemit lidhur me plotësimin e kërkesave të arsyeshme për transmetimin e energjisë elektrike. Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST), është një nga pjesëtarët kryesorë të tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.

Bazuar në këtë rol të rëndësishëm, kompania mbështetet në planet afatmesme dhe afatgjata të zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike në vend.

OST sh.a. në përmbushje
të përgjegjësisë të saj vepron si:



Në mënyrë të përmblodhur, përgjegjësitë kryesore të OST sh.a. që burojnë nga aktet ligjore, nënligjore dhe rregullatore në fuqi janë si më poshtë:

OST sh.a. është përgjegjëse për:

Menaxhimin e flukseve të energjisë në sistemin e transmetimit të energjisë

Shërbimet e balancimit të sistemit

Zhvillimin e rrjetit të transmetimit, për të garantuar sigurinë e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike

Mbulimin e humbjeve në rrjet dhe sigurimin e shërbimeve ndihmëse

Alokimin e kapaciteteve ndërkufitare

Lidhjen e përdoruesve me rrjetin e sistemit të transmetimit

2. MISIONI, PËRPARËSITË DHE STRATEGJITË

MISIONI

OST sh.a. është një kompani që siguron shërbime me cilësi të lartë për të gjithë përdoruesit e sistemit të transmetimit, bazuar në standardet, arritjet dhe praktikatat më të mira, të cilat aplikohen nga operatorët e sistemeve të transmetimit të ENTSO-E, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të Shqipërisë dhe shkëmbimin e sigurt dhe cilësor të energjisë elektrike në vend dhe rajon.

PËRPARËSITË DHE STRATEGJITË

- Zhvillimi i rrjetit të transmetimit në përputhje me pritshmëritë, dhe planet e zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike si një e tërë.
- Zhvillimi i kapaciteteve ndërkuftare në përputhje me projektet rajonale dhe më gjerë në bashkërendim me planet dhe projektet zhvillimore të rajonit.
- Kryerja e investimeve strategjike dhe investimeve në drejtim të zëvendësimit të teknologjisë së vjetruar, si dhe integritit të teknologjisë bashkëkohore drejt menaxhimit në mënyrë inteligjente të rrjeteve elektrike.
- Përfshirja proaktive në iniciativat rajonale dhe evropiane.
- Sigurimi i kushteve të përshtatshme të operimit të tregut të energjisë elektrike në përputhje me zhvillimet e pritshme të tregut.
- Funksionimi me efektivitet dhe eficiencë për ruajtjen dhe garantimin e qëndrueshmërisë së sistemit elektroenergjetik shqiptar.
- Sigurimi i stabilitetit financiar të kompanisë.
- Bashkëpunimi i ngushtë me Entin Rregullator të Energjisë, për të siguruar një model transparent dhe konkurrues të tregut të energjisë elektrike.
- Sigurimi i mjedisit si punëdhënës tërheqës në tregun e punës në Shqipëri.
- Respektimi i të gjitha politikave mjedisore në përputhje me standardet evropiane në menaxhimin dhe zhvillimin e rrjetit të transmetimit.

OST sh.a. është vazhdimisht në kërkim të përmirësimit të performancës së saj teknike, ekonomike dhe financiare, për të përmbushur standardet më të mira ndërkombëtare të Komunitetit të Tregut të Energjisë Elektrike dhe të organizatave evropiane, të cilat nxisin dhe monitorojnë hapjen e tregut të brendshëm të energjisë elektrike, si dhe integrimin e këtij tregu në tregun rajonal dhe evropian të energjisë.

Në përputhje me parashikimet e LTA, OST sh.a. ka marrë pjesë në të gjitha strukturat e organizmit teknik të ENTSO-E, përfaqësuar nga ekspertët përkatës, si dhe në Asamblenë e Përgjithshme të ENTSO-E.

Shqipëria është një ndër vendet nënshkruese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë në lidhje me zhvillimin rajonal të sektorit të energjisë elektrike, dhe të gazit natyror në Evropën Juglindore. Ky traktat u kërkon vendeve anëtare dhe vendit tonë që të përfaqësojnë dhe të përshtatin kuadrin ligjor me *acquis communautaire* të BE-së në katër fusha, duke përfshirë Direktivën për Tregun e Brendshëm të Energjisë Elektrike dhe të Rregullores për Shkëmbimin e Energjisë Elektrike ndërmjet vendeve fqinje.

OST sh.a. është një prej shoqërive themeluese të SEE CAO (South East Europe Capacity Allocation Office) së bashku me shoqëritë e transmetimit të Malit të Zi, Kroacisë, Greqisë, Kosovës, Bosnje Hercegovinës, Turqisë, dhe Maqedonisë.

Që prej vitit 2015 SEE CAO zhvillon procesin e ankandëve të kapaciteteve të interkonjeksionit me bazë vjetore, mujore dhe ditore. Duhet theksuar se aktualisht, për shkak të mosnjohjes së Kosovës si zonë rregulluese, ankandet e kapaciteteve mujore dhe ditore për kufirin me Kosovën zhvillohen nga vetë OST sh.a.

SEE CAO është një provë reale e përpjekjeve të bashkëpunimit rajonal ndërmjet OST-ve të rajonit, e cila krijon kushte të përshtatshme për zhvillimin e tregut të përbashkët të energjisë në rajon. Ligji Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, ashtu sikurse edhe anëtarësimi në ENTSO-E, e vendos OST-në përballë një perspektive të re, e cila kërkon përshtatjen e sektorit elektroenergjetik ndaj tregut të energjisë, dhe si rrjedhojë edhe OST-në me modelet evropiane. Një ndër fushat e zhvillimit të sektorit në një të ardhme të afërt, është dhe krijimi i Bursës së Energjisë Elektrike në të cilën OST sh.a. pritet të jetë aksioneri kryesor.

Në këtë prizëm Komiteti Drejtues, ngritur nën drejtimin e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë, pjesë aktive e së cilës është dhe Operatori i Tregut, po punon gjerësisht me të gjithë pjesëtarët e tregut për krijimin e kushteve, masave dhe hapave ligjore dhe teknike që duhen ndërmarrë për krijimin dhe funksionimin e suksesshëm të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike sipas praktikave më të mira evropiane dhe bashkimit me Tregun Panevropian në mbështetje të detyrimeve dhe angazhimeve të ndërmarra nga Qeveria Shqiptare që lindin nga Procesi i Berlinit.

3. ÇËSHTJET MJEDISORE

OST vlerëson ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit si një prej detyrave të saj me përparësi dhe është po punon vazhdimisht për të përmirësuar performancën mjedisore të kompanisë. OST-ja ka hartuar dhe zbaton tashmë politika mjedisore që janë publikuar në faqen e internetit të kompanisë. Zbatimi i politikave të mjedisit realizohet nëpërmjet Planeve të Veprimit, të cilat detajojnë të gjitha aspektet e identifikuara mjedisore. Politika e OST-së për mjedisin mbështetet në tre shtylla kryesore:

a) Menaxhimi i çështjeve mjedisore të OST-së është zhvilluar në përputhje me ligjet, rregulloret dhe kërkesat mjedisore të infrastrukturave të sektorit të energjisë elektrike.

OST sh.a. zbaton legjislacionin mjedisor për të gjitha projektet që në fazën e parë të projektimit, gjatë zbatimit, si dhe pas realizimit të projekteve. Çdo projekt është në përputhje me:

- Ligjin Nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, mbi parandalimin dhe marrjen e masave për përmirësimin e kushteve mjedisore dhe cilësisë së jetës, si dhe sigurimin e kushteve për një zhvillim të qëndrueshëm.
- Ligjin Nr. 10440, datë 07.07.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar me ligjin 12/2015 duke siguruar për çdo projekt një Deklaratë Mjedisore/Vendim për VNM Paraprake në varësi të llojit të projektit dhe shtrirjes së tij.

OST sh.a. merr të gjitha masat për zbatimin e legjislacionit për pyjet e kullotat në rast se projekti kalon sipërfaqet pyjore ose kullotat duke bërë të mundur sigurimin e të gjitha dokumentacioneve të nevojshme.

b) Përmirësimi i performancës mjedisore bëhet nëpërmjet sensibilizimit të përshtatshëm të stafit dhe trajnimet përkatëse për këtë çështje;

c) Parandalimi dhe zbutja e ndikimeve mjedisore, duke kryer monitorimin dhe kontrollin e emetimit të gazrave në natyrë dhe ruajtja e sasisë së ndotjes brenda standardeve të pranura për të menaxhuar mbrojtjen dhe qëndrueshmërinë e burimeve natyrore.

Për të gjitha projektet:

- Hartohet raport paraprak i “Vlerësimit të ndikimit në mjedis” në të cilin përshkruhen dhe vlerësohen efektet direkte dhe indirekte të projektit te njerëzit, flora dhe fauna, ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore, klimën, terreni dhe ndërtimi i tij, dhe ndërveprimi i këtyre faktorëve me trashëgiminë kulturore, shoqërore dhe mjedisore. Me vlerësimin e efekteve që mund të shkaktohen në mjedis, hartohen masat e nevojshme që duhet të merren për parandalim apo eliminimin e ndikimeve negative në mjedis.
- Bëhet informimi dhe ndërgjegjësimi i publikut në lidhje me ndikimet negative që mund të shkaktohen si pasojë e zbatimit të projekteve.
- Zbatohen të gjitha kushtet mjedisore të vendosura në Deklaratën Mjedisore apo Vendimin për VNM Paraprake duke marrë masat për të shmangur, reduktuar apo pakësuar të gjitha ndikimet e padëshirueshme në mjedis.
- Kryhen monitorime/inspektime në terren të objekteve, aseteve, ekipeve të mirëmbajtjes dhe procesit gjatë realizimit të projekteve, si dhe gjatë funksionimit të tyre.
- Kryhet rehabilitimi i sipërfaqeve të prekura apo të dëmtuara nga projekti, si dhe rimbjellja e këtyre sipërfaqeve pyjore, duke u bazuar në legjislacionin e pyjeve për të bërë të mundur përmirësimin e gjendjes mjedisore.

Në bazë të politikave të mjedisit, menaxhimi ka caktuar objektiva mbi ndikimet mjedisore që shkaktohen nga ushtrimi i veprimtarisë së kompanisë. Një bazë e fortë për menaxhimin e çështjeve mjedisore është Sistemi i Menaxhimit Mjedisor në përputhje me standardin evropian ISO 14001.



II. MODELI I DREJTIMIT TË OST SH.A.

1. STRUKTURAT DREJTUESE

OST sh.a. drejtohet nga:

Këshilli Mbikëqyrës

Administratori

Këshilli Mbikëqyrës i OST sh.a. përbëhet nga gjashtë (6) anëtarë të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme. Në 31 dhjetor 2016, Këshilli Mbikëqyrës përbëhej nga:

PAJTIM BELLO
Kryetar

NIKOLLA LERA
Anëtar

ARBEN DHIMO
Anëtar

ARTUR LAMA
Anëtar


ETJEN XHAFA
Anëtar

ENKELEJD MUSABELLIU
Anëtar

Këshilli Mbikëqyrës i OST sh.a. ka emëruar:

ENGJËLL ZEQO
Administrator i OST sh.a.

STRUKTURA E RE ORGANIZATIVE E OST SH.A.





SHPËRNDARJA E QENDRAVE ADMINISTRATIVE TË OST SH.A.

- | | |
|---|-----------------------------|
| 1. Njësia Operative Shkodër | 4. Njësia Operative Elbasan |
| 2. Njësia Operative Burrel | 5. Njësia Operative Fier |
| 3. Administrata Qendrore:
Njësia Operative Tiranë
Njësia e Mirëmbajtjes së Transmetimit | 6. Njësia Operative Korçë |

2. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE


Struktura e organizimit të OST-së është e thjeshtë dhe fleksibël dhe lejon përmirësime të mëtejshme dhe krijimin e njësive të reja në bazë të kësaj strukture.

Stafi mesatar i OST-së për vitin 2016 është i përbërë nga 715 punonjës. Stafi i OST-së është i motivuar dhe i aftë për të përmbushur objektivat strategjike dhe zbatimin e projekteve të reja, të cilat janë gati në fazën përfundimtare me efikasitet të lartë.


Kërkesat e OST-së për rekrutim të stafit të ri të janë të lidhura ngushtë me detyrimet që vijnë si rezultat i respektimit të standardeve ligjore, si dhe i kërkesave të anëtarësimit në ENTSO-E.

Politikat e burimeve njerëzore mbulojnë planifikimin e rekrutimeve të burimeve njerëzore, rekrutimin dhe përzgjedhjen, zhvillimin e aftësive, menaxhimin e performancës dhe shpërblimet, barazinë gjinore dhe përfshirjen e pakicave të tjera etnike.

ADMINISTRATA QËNDRORE




NJËSITË PËRBËRËSE




*Personeli sipas moshës

ADMINISTRATA QËNDRORE



NJËSITË PËRBËRËSE



*Raporti gjinor i personelit

III. DREJTIMI OPERATIV I SISTEMIT

OST sh.a. në rolin e Operatorit të Sistemit operon Sistemin Elektroenergjetik duke përdorur teknikat më të mira bashkëkohore mbi operimin e sistemit të transmetimit dhe komponentëve të tij, duke siguruar balancën ndërmjet gjenerimit, shkëmbimit dhe konsumit të energjisë elektrike. OST sh.a. bën operimin e rrjetit në përputhje me dispozitat e Ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Kodin e Rrjetit të Transmetimit, Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike, marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe, si dhe aktet e tjera ligjore në fuqi. Sistemi i Transmetimit operon në përputhje me të gjithë udhëzimet dhe politikat e ENTSO-E, veçanërisht parashikimet e Manualit Operacional të ENTSO-E, si dhe udhëzuesin mbi Sigurinë e Operimit të Sistemit të Transmetimit (SO GL).

OST si operator i sistemit është përgjegjës për:

Operimin e sistemit të prodhimit dhe transmetimit në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit dhe standardeve të ENTSO-E

Planifikimin e mbulimit të kërkesës me bazë ditore/orare, planifikimin orar për çdo central dhe kontrollin e nivelit të sigurisë së operimit duke përdorur kriterin e sigurisë n-1

Menaxhimin e shërbimeve ndihmëse të domosdoshme për funksionimin normal të sistemit

Menaxhimin e gjenerimit dhe kërkesën e energjisë elektrike në kohë reale, duke siguruar balancën ndërmjet gjenerimit, shkëmbimit dhe konsumit të energjisë elektrike

Shkëmbimin dhe harmonizimin e planifikimit orar të shkëmbimit të energjisë me OST-të fqinje, për ditën pasardhëse, si dhe llogaritjen e shkëmbimit të energjisë për çdo interkonektor për ditën paraardhëse

Analizën e punës së Sistemit Energjetik dhe propozon masa korrekte për ruajtjen e sigurisë së punës, në bashkërendim me Përdoruesit e Rrjetit, OST-të e rajonit dhe Qendrën Koordinative Rajonale

Parashikimin e regjimit të punës së Sistemit Energjetik në terma afatshkurtër e afatmesëm


Në bashkëpunim me OST-të fqinje, përcakton kapacitetin transmetues ndërkufitar për çdo kufi e drejtim të fluksit të energjisë me bazë vjetore, mujore dhe ditore

Operimi në kohë reale i sistemit të transmetimit realizohet nëpërmjet Qendrës Kombëtare Dispeçer. Në fillim të vitit 2016 përfundoi ndërtimi i Qendrës së re Kombëtare Dispeçer e cila është aktualisht në operim duke bërë monitorimin, kontrollimin dhe marrjen e masave përkatëse për ruajtjen e sigurisë së punës së sistemit elektroenergjetik, në bashkërendim me përdoruesit e rrjetit, OST-të fqinje në bazë të informacionit të marrë në kohë reale.

BILIANCI I ENERGJISE PËR VITIN 2016

	Njësia	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Prodhimi vendas	(GWh)	462	726	877	393	800	479	353	368	310	392	826	649	6,636
Energjia në marrje	(GWh)	257	70	95	188	74	93	213	215	203	183	48	189	1,827
Totali i energjisë që hyn në sistem	(GWh)	719	795	972	580	874	572	566	583	513	575	874	838	8,462
Energjia në dhënie	(GWh)	49	252	410	103	377	100	25	29	25	64	315	122	1,869
Energjia e transmetuar për OSHEE	(GWh)	621	500	511	415	417	429	490	501	430	444	492	565	5,901
Energjia e transmetuar për konsumatorët e tjerë	(GWh)	35	25	28	49	58	35	38	39	49	55	48	45	503
Totali i energjisë së transmetuar	(GWh)	704	777	949	567	852	559	553	569	503	564	855	822	8,272
Humbjet në sistemin e transmetimit	(GWh)	14	18	24	14	22	13	13	13	10	11	19	16	190

Operimi i Sistemit Elektroenergjetik kërkon kontroll dhe monitorim të vazhdueshëm si pasojë e ndryshimeve dinamike të ngarkesës dhe gjenerimit. Parametri kryesor që nuk duhet të ndryshojë pavarësisht regjimeve të punës është frekuenca ($f=50\text{Hz}$). Funksionimi korrekt i kontrollit fuqi-frekuence dhe rezerva primare e ofruar nga burimet gjeneruese të lidhur në rrjetin e transmetimit kanë kontribuar në ruajtjen e balancës dhe cilësinë e frekuencës në zonën e kontrollit të OST-së. Cilësia e mbajtjes së balancës dhe njëkohësisht programit të shkëmbimit mund të vihen re duke kontrolluar gabimin e zonës së kontrollit sipas grafikut më poshtë, në të cilin orët me gabim zone jashtë diapazonit $\pm 20\text{MW}$ përbëjnë një pjesë relativisht të vogël.




Më sipër paraqitet frekuenca e ACE me intervale ± 20 , d.m.th për çdo kolonë paraqitet numri i ACE brenda intervalit ± 10 për kolonën me vlerë 0, e kështu në vijim për çdo kolonë.

Po kështu, më lart është paraqitur, në vlerë absolute dhe relative, frekuenca e gabimit të zonës sipas intervalit ± 20 MW. Gjatë vitit 2016, në Sistemin e Transmetimit nuk janë shfaqur avari të rënda apo ngjarje të paparashikuara të shoqëruara me ndërprerjen apo kufizimin e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve në vend. Si pasojë e menaxhimit efikas të sistemit të transmetimit dhe investimeve në rrjetin e transmetimit janë reduktuar ndërprerjet në avari të elementeve të rrjetit duke garantuar furnizimin e pandërprerë me energji elektrike për të gjithë përdoruesit e rrjetit të transmetimit.


Gjenerimi nga burimet hidrike dominon sektorin e gjenerimit të vendit, dhe rrjedhimisht prodhimi i energjisë elektrike në Shqipëri është shumë i varur nga kushtet hidrologjike gjatë vitit duke variuar afërsisht nga 3 TWh në një vit të thatë, në 7 TWh në një vit me lagështirë.

Ky ndryshim i madh i prodhimit në vitet e thata dhe në vitet e lagështa, e ul besueshmërinë e sistemit gjenerues dhe kërkon domosdoshmërisht sigurimin e energjisë elektrike nga importi për të plotësuar kërkesën e vendit për energji elektrike. Mjaftueshmëria e sistemit arrihet nëpërmjet kontratave të importit të cilat realizohen nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike pasi ka siguruar nga KESH mbulimin e një pjese të konsumit. Gjatë viteve të fundit vihet re se varësia nga importi është ulur si pasojë e shtimit të burimeve të reja gjeneruese, kryesisht të lidhura në sistemin e transmetimit, por edhe burimet e reja gjeneruese të lidhura në sistemin e shpërndarjes.

Në tabelën në vijim paraqitet prodhimi, konsumi dhe shkëmbimet gjatë viteve të fundit:




Përgjithësisht, konsumi i energjisë elektrike ishte në linjë me vlerat e parashikuara në planifikimin vjetor, ku mund të vihet re një ulje e konsumit të përgjithshëm të vendit (rreth 4% më pak krahasuar me një vit më parë), si rrjedhojë e masave të marra nga OSHEE sh.a. për uljen e humbjeve joteknike në rrjetin e shpërndarjes. Gjithsesi reduktimi ngarkesës është më i ulët krahasuar me vitet 2014-2015, e cila arriti në vlerën 10%.






Në aspektin e mjaftueshmërisë së gjenerimit, viti 2016 mund të konsiderohet përgjithësisht si vit me gjenerim të mjaftueshëm duke qenë se balanca totale e energjisë në sistemin e transmetimit është pozitive me një vlerë relativisht të vogël (+42GWh). Në disa muaj të vitit 2016, përveç mbulimit të konsumit të vendit, është eksportuar rreth 20-25% e prodhimit të hidrocentraleve.



Më 31.12.2016 vihet re një rritje e ngarkesës pik me 4% në krahasim me vitin 2015, megjithatë sistemi transmetimit ka pasur në dispozicion kapacitet të mjaftueshëm për të akomoduar flukset në rrjetin e brendshëm dhe në interkonektor.



TREGU I ENERGJISË BALANCUESE

Zhvillimet në Tregun e Energjisë dhe Modelin e Tregut, në përputhje me Ligjin 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, sollën ndryshime edhe në strukturën organizative të OST sh.a. si hap i rëndësishëm dhe i domosdoshëm për funksionimin e tregut të energjisë balancuese, si dhe sigurimin e shërbimeve të balancimit dhe ato ndihmëse, të nevojshme për funksionimin e sistemit, nëpërmjet një procedure konkurruese, transparente dhe jodiskriminuese, me synimin e një tregu të liberalizuar.


Ndryshimet në Rregullat e Tregut gjatë vitit 2016, të miratuara nga ERE, përcaktuan vendosjen e OSHEE sh.a si subjekt disbalance. Në vijim të praktikave ekzistuese dhe në zbatim të ndryshimeve në Rregullat e Tregut, mbi bazën e të dhënave orare të marra nga sistemi i matjeve i OST-së, janë bërë llogaritjet e disbalancave për secilin Pjesëmarrës Tregu. Janë vlerësuar disbalancat e palëve me bazë mujore, të cilat me pas u janë faturuar pjesëmarrësve të tregut. Po kështu, me bazë mujore janë llogaritur dhe kompensuar edhe KESH-sh.a. për balancimin e sistemit të transmetimit.

Në Tabelat dhe grafikët në vijim paraqitet një përmbledhje në total e volumeve të devijimeve mbi tolerancën prej $\pm 1\%$ të Pjesëmarrësve të Tregut, për periudhën janar-qershor, dhe periudhën korrik-dhjetor pasi sipas vendimit të ERE, në periudhën e dytë toleranca është hequr duke ia caktuar tërësisht përgjegjësinë balancimit atij që e shkakton.


Disbalancat

VITI 2016	Disbalanca negative mbi 1%	Disbalanca pozitive mbi 1%	VITI 2016	Disbalanca negative	Disbalanca pozitive
	MWh	MWh		MWh	MWh
Janar	1.400	2.573	Korrik	7.111	13.242
Shkurt	404	2.701	Gusht	4.037	9.824
Mars	306	1.545	Shtator	4.314	14.885
Prill	391	447	Tetor	4.937	19.196
Maj	752	1.580	Nëntor	8.096	17.841
Qershor	159	837	Dhjetor	8.251	9.431
Shuma	3.411	9.684	Shuma	36.745	84.420

MWh Disbalancat jashtë zonës ± 1%



MWh Disbalancat



SHËRBIMET NDIHMËSE DHE HUMBJET NË RRJET

Për sa i përket Shërbimeve Ndhmëse në sistemin e transmetimit vlen të përmendet se gjatë vitit 2016, kanë vijuar përpjekjet në procesin e hartimit të kuadrit rregullator.

Shërbimet ndihmëse aktualisht ofrohen vetëm nga Gjeneruesi Publik KESH sh.a. deri në krijimin e një tregu të shërbimeve ndihmëse, sigurimi i tyre dhe i energjisë balancuese për balancimin e sistemit Elektroenergjetik është realizuar me çmim të rregulluar sipas marrëveshjes me KESH sh.a.

PLANIFIKIMI I REGJIMIT TË PUNËS (PLANIFIKIMI OPERACIONAL)

Në përputhje me Kodin e Rrjetit të Transmetimit, Rregulloren e Punës së Drejtorisë së Drejtimit Operativ, Politikat 3 dhe 4 të Manualit Operacional, udhëzuesin mbi operimin e sistemit (SO GL) janë kryer llogaritjet mbi gjendjen aktuale (kontrolli i kriterit N-1) dhe parashikimet me bazë ditore, javore, mujore, vjetore. Në vijim janë përditësuar modelet e rrjetit me përdoruesit e rinj duke kryer analiza me anë të software-ve për simulime të sistemit elektroenergjetik duke rritur besueshmërinë e operimit në tërësi.

Në lidhje me planifikimin operativ janë analizuar skenarë të ndryshëm kontigjencash, të cilët i janë vënë në dispozicion Qendrës Kombëtare Dispeçer. Gjithashtu janë kryer llogaritje të ndryshme me anë të softleve për simulime, si p.sh., llogaritja e NTC, studimi i qëndrueshmërisë statike të SE, por edhe të atij të Evropës Juglindore (SEE), krijimi i modelit mujor në avancë M+2 (për orën 10:30 të mërkurës së tretë të muajit), etj.

Shfrytëzimi i rezultateve të analizave të kryera gjatë procesit të planifikimit operativ kanë ndihmuar në vazhdimësi Qendrën Kombëtare Dispeçer në marrjen e vendimeve mbi operimin me efikasitet të rrjetit të transmetimit.

Gjatë vitit 2016, OST sh.a. është bashkuar me OST-të e tjera në ENTSO-E, në Projektin e Vlerësimit të Mjaftueshmërisë së Sistemit në terma afatshkurtër dhe afatmesëm. Ky projekt koordinohet nga qendrat e sigurisë CORESO, TSC, SCC. Në thelb vlerësimi i mjaftueshmërisë konsiston në vlerësimin e mjaftueshmërisë së prodhimit të energjisë elektrike në një zonë kontrolli në aspektin e përmbushjes së kërkesës së pritshme në intervale të caktuara kohore. Vlerësimi i mjaftueshmërisë realizohet duke krahasuar inputet e mjaftueshmërisë të çdo zone kontrolli të veçantë, me kapacitetin e mbetur gjenerues për të kryer shkëmbime ndërkufitare dhe disponibilitetit të NTC.



*VENDET PJESËMARRËSE NË PROJEKTIN E VLERËSIMIT TË MJAFTUESHMËRISË
NË TERMA AFATSHKURTËR DHE AFATMESËM

■ Vendet jopjesëmarrëse

■ Vendet pjesëmarrëse

PLATFORMAT DHE SISTEMET E OPERIMIT

Në Operatorin e Sistemit të Transmetimit, janë përdorur disa platforma automatike që shfrytëzohen për operimin e sistemit në kohë reale dhe për menaxhimin e të dhënave të ndryshme. Ndër këto sisteme përmendim:

› Platforma e menaxhimit të rrjetit energjetik

“Network Mannager”. Kjo platformë ofron të gjithë funksionalitet e SCADA/EMS (Supervisory Control and Data Acquisition / Energy Management System), si dhe një sërë funksionesh të tjera. Gjatë vitit 2016 kjo platformë është vendosur në godinën e re të OST sh.a. dhe ka qenë në operim të plotë. Aplikacionet e “Network Mannager” përdoren gjithashtu për kryerjen e kontrolleve dhe analizave në kohë reale, si dhe për qëllime optimizimi dhe planifikimi. Këto mjete të fuqishme të operimit të rrjetit na ofrojnë lehtësi e operim të dobishëm ditor.

Në kuadër të vendosjes së sistemit SCADA në qendrën e re Dispeçer, gjatë vitit 2016, në Qendrën Kombëtare Dispeçer u instalua Videowall-i që ndihmon në paraqitjen në një skeme të përbashkët të të gjithë rrjetit të transmetimit. Ky investim ka qenë mjaft eficient në manovrimet dhe në operimin e sistemit energjetik duke rritur kontrollin dhe besueshmërinë nëpërmjet sistemit SCADA.

› Sistemi Back-Up SCADA

Krahas platformës “Network Mannager”, në OST sh.a. është përdorur edhe platforma “E-TERRA” e cila shërben si sistem Back-Up për Qendrën Kombëtare Dispeçer. Nëpërmjet këtij sistemi monitorohen dhe kontrollohen Nënstacionet 400 kV dhe 220 kV. Krahas Nënstacioneve në sistemin “E-TERRA”, në kuadrin e LFC monitorohen dhe operohen edhe centrale të KESH sh.a.

› Sistemi Emergjent i Kontrollit

Sistem i cili është një investim i vitit 2016, përbën një nga kushtet e ENTSO-E. Platforma Emergjente “Prozant” është publikuar në të gjithë hallkat e marrjes dhe transmetimit të të dhënave. Kjo platformë është e vendosur në nënstationin Tirana2 dhe siguron të gjitha funksionalitetet për monitorim dhe kontroll të sistemit të Transmetimit. Në këtë platformë, krahas centraleve të KESH sh.a., funksionaliteti LFC do të zbatohet edhe për HEC Banjë dhe HEC Fangun.

› Rrjeti ELECTRONIC HIGHWAY (EH) - OST sh.a.

Duke qenë pjesë e Rrjetit të Transmetimit Evropian dhe për t'i përmbushur standardet e ENTSO-E, ka përmbushur detyrimet lidhur me ndërfaqësimin me OST-të e tjera, si dhe me vetë ENTSO-E. Në këtë kuadër, OST sh.a. ka përmbushur të gjitha kërkesat për të qenë pjesë zyrtare e “Electronic Highway”, si dhe ka iniciuar përpunimin e të dhënave të nevojshme për Platformën e Transparencës së ENTSO-E. Electronic Highway (EH) është një rrjet i dedikuar i mbyllur ndërmjet OST-ve të Evropës. Nëpërmjet këtij rrjeti shkëmbehen të dhëna në kohë reale, si dhe në kohë joreale. OST sh.a., duke iu përmbajtur direktivave të ENTSO-E, ka zbatuar nyjën e rrjetit të instaluar në Qendrën Kombëtare Dispeçer.

› Sistemet/Pajisjet Lokale të Kontrollit

Sistemet SCADA furnizohen me të dhëna në kohë reale nga pajisjet RTU dhe/apo nga sisteme lokale të monitorimit të instaluar nëpër Nënstacione. Transferimi i këtyre të dhënave mundësohet nga rrjeti i Telekomunikacionit të OST sh.a. Nënstacionet 400kV/220kV janë të gjitha të pajisura me sisteme lokale kontrolli, si dhe pjesërisht me RTU për mundësimin e të dhënave nëpërmjet dy burimeve. OST sh.a., gjithashtu ka të instaluar RTU në shumë Nënstacione 110kV. Gjatë vitit 2016 ka pasur zhvillime edhe në kuadër të këtyre sistemeve lokale të kontrollit/RTU-ve. Ndër këto mund të përmendim instalimin e pajisjeve RTU në nënstationet e Sarandës, Përmetit, Korçës, Peshkopisë dhe Kukësit. Aktualisht, këto pajisje mbledhin të dhëna nga elementet e nënstationeve përkatëse.

› Platforma Elektronike për Menaxhimin e Tregut të Energjisë Elektrike

Përdoret për të operuar rrjetin e transmetimit sipas kërkesave të ENTSO-E, të reflektuara në Manualin e Operimit dhe politikave rregulluese, si dhe për të krijuar kushtet e përshtatshme të funksionimit të tregut të energjisë.

OST sh.a. ka në përdorim platformën e saj elektronike të tregut të energjisë elektrike DAMAS, një investim ky i realizuar gjatë vitit 2016, me burime financiare të OST sh.a. Platforma e tregut, mundëson automatizimin dhe shkëmbimet fizike të energjisë elektrike ndërmjet pjesëmarrësve në tregut vendas, si dhe në tregun rajonal të energjisë elektrike.

Nëpërmjet platformës elektronike realizohet harmonizimi i shkëmbimeve fizike të deklaruara nga pjesëmarrësit e tregut vendas të energjisë me Operatorët e Sistemeve Rajonale të Transmetimit me të cilët jemi të lidhur nëpërmjet linjave të interkonjeksionit. Ndërkohë, dhënia e të drejtës për përdorimin e kapaciteteve të interkonjeksionit, si një mekanizëm i cili mundëson tregtimin e energjisë elektrike në drejtim të tregjeve rajonale, realizohet nëpërmjet platformës në mënyrë të automatizuar. Pjesëmarrësit e tregut kanë mundësinë që nëpërmjet procedurës elektronike të marrin pjesë në ankandet që zhvillohen nga OST për dhënien e kësaj të drejte dhe të informohen mbi rezultatet, sipas një procesi të programuar dhe rregullave tërësisht transparente.

Bazuar në parimin e transparencës, nga pikëpamja e funksionit dhe menaxhimit të aspekteve të biznesit që realizohen në tregun e brendshëm të energjisë, Platforma e Operimit të Tregut do të sigurojë raportimin e të dhënave të proceseve të biznesit që realizon në Platformën e Transparencës së ENTSO-E (ETP) për tregun Pan-Evropian.

KONTROLLI I ZBATIMIT TË KODIT TË RRJETIT NGA PËRDORUESIT

Objekti i OST përgjatë vitit 2016 ka qenë përmirësimi i mëtejshëm i bashkëpunimit dhe bashkërendimi me të gjithë përdoruesit e Rrjetit të Transmetimit dhe/ose pjesëmarrësit e Tregut të Energjisë Elektrike për zbatimin e plotë të dispozitave të Kodit të Rrjetit të Transmetimit dhe Kodeve të Rrjetit të ENTSO-E, si dhe ndjekja dhe trajtimi i çështjeve rregullatore apo detyrimeve që përcakton Ligji Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

➤ **Administrimi i Kodit dhe Hartimi i Akteve Teknike Rregullatore**

Fokusi ka qenë në evidentimin dhe trajtimin e problematikes së ndeshur në lidhje me zbatimin e Kodit të Rrjetit të Transmetimit nga përdoruesit e rrjetit, si kusht për plotësimin e standardeve të sigurisë operative në rrjetin e transmetimit, si dhe për garantimin e furnizimit të qëndrueshëm dhe të pandërprerë me energji elektrike. Për këtë, OST ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme aktivitetin dhe performancën e përdoruesve të rrjetit të transmetimit duke monitoruar, komunikuar dhe udhëzuar sipas rastit, mbi njohjen dhe zbatimin e plotë të dispozitave të KRRT me qëllim rritjen e sigurisë operacionale, shmangien e ngjarjeve shqetësuese në sistem dhe përmirësimin e funksionimit të sistemit elektroenergjetik në tërësi.

➤ **Monitorimi i Përdoruesve**

Në përputhje me kërkesat e Kodit të Rrjetit të Transmetimit, OST ka monitoruar dhe inspektuar performancën e përdoruesve nëpërmjet marrjes së informacionit, analizës së të dhënave dhe inspektimit në vend. Aktiviteti monitorues është konsideruar një mënyrë tepër efektive për rritjen e bashkëpunimit dhe përmirësimin e performancës së përdoruesve duke trajtuar problematikën e zbatimit korrekt të dispozitave të këtij kodi. Është konstatuar se nga ana e personelit teknik dhe operativ të Përdoruesve të Rrjetit të Transmetimit reflektohen mangësi të njohurive përkatëse për zbatimin e plotë të dispozitave të përcaktuara në Kodin e Transmetimit, si dhe mungesa e dokumentimit formal të trajnimit të personelit, i cili në shumicën e rasteve është i kufizuar vetëm në trajnimin lidhur me masat e sigurimit teknik.

BASHKËPUNIMI RAJONAL DHE ME ENTSO-E

Përveç aktiviteteve në lidhje me sektorin e energjisë në vend, OST është aktivizuar edhe në të gjitha aktivitetet për Evropën Kontinentale Juglindore të ENTSO-E, si p.sh.: Grupi Rajonal i vendeve të Evropës Juglindore (RGSEE), Grupi i Operimit të Koordinuar të Sistemit ENTSO-E, Iniciativa e bashkëpunimit të vendeve të Evropës Juglindore për Planifikimin e Sistemit të Transmetimit (SECI-USAID/USEA), ENTSO-E Awareness System (ENTSO-E EAS), ENTSO-E CE NMFT-Grupi i Modelimit të rrjetit dhe softet e modelimit, etj.

OST sh.a. është anëtare e Komunitetit të Energjisë me bazë në Vjenë. Misioni i Komunitetit të Energjisë është zgjerimi i tregut të brendshëm të energjisë të Bashkimit Evropian për Evropën Juglindore dhe më gjerë në bazë të një kuadri të detyrueshëm ligjor. Instrumenti kryesor për të arritur këtë qëllim është përshtatja e legjislacionit të BE-së, të ashtuquajturit “acquis communautaire”, në fushën e energjisë dhe fushat që lidhen me të.

Në kuadër të monitorimit, verifikimit dhe përmbushjes së standardeve të besueshmërisë së operimit të rrjetit, në përputhje me kërkesat e Manualit Operacional të ENTSOE, në muajin shtator 2016, OST sh.a., u auditua në lidhje me pajtueshmërinë me kërkesat e Politikës 5 për “Operimi në Emergjencë”. Qëllimi i auditimit konsistonte në verifikimin e praktikave të ndjekura dhe informacionit të paraqitur/deklaruar nga OST sh.a. gjatë fushatës së vetëvlerësimit gjatë vitit 2015 dhe pajtueshmëria me kërkesat e Manualit Operacional (OH) të ENTSOE.

OST shfaq angazhimin maksimal për evidentimin qartë të dokumentacionit si: Marrëveshjet Operacionale me OST-të fqinje, Marrëveshjet Operacionale me KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., Plani i Mbrojtjes, Plani i Rivendosjes, Plani i Evakuimit, Sistemet Automatike dhe Infrastruktura e Komunikimit të OST, Test raportet e funksionaliteteve të qendrës kryesore të komandimit dhe asaj të emergjencës, Rregullores së Qendrës Kombëtare Dispeçer, raporte dhe relacione të ndryshme, etj.

Në përfundim të procesit të auditimit në vend dhe verifikimit të të gjithë dokumentacionit mbështetës, Grupi i Auditimit arriti në përfundimin se OST sh.a. është plotësisht në pajtueshmëri me të gjitha standardet e audituara.

Gjithashtu, në muajin maj 2016, OST mori pjesë si anëtare e grupit auditues, gjatë procesit të auditimit të shoqërisë SWISSGRID për Politikën 5.

IV. SHFRYTËZIMI DHE MIRËMBAJTJA E RRJETIT TË TRANSMETIMIT

OST sh.a. punon në vazhdimësi për të mirëmbajtur dhe zhvilluar Sistemin e Transmetimit të Energjisë Elektrike, në përputhje me parashikimin afatgjatë të kërkesës për energji elektrike dhe burimeve të reja gjeneruese, duke bashkërenduar zhvillimin e rrjetit të interkonjeksionit me vendet fqinje.

OST si operator i rrjetit të transmetimit është përgjegjës për:

Operimin e integruar dhe funksionimin e sigurtë të Sistemit Elektroenergjetik

Zhvillimin e rrjetit të transmetimit në përputhje me parashikimet afatgjata dhe me planet e zhvillimit të Sektorit Elektroenergjetik

Mirëmbajtjen e rrjetit të transmetimit dhe pajisjeve në përputhje me kërkesat teknike të sigurisë dhe të funksionimit

Mirëmbajtjen e infrastrukturës së telekomunikacionit dhe sistemit të matjes

Mirëmbajtjen dhe zhvillimin e aseteve ndihmëse të transmetimit

Krijimin e aksesit për të gjithë pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike

Furnizimin e klientëve konsumatorë të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit

Menaxhimin e ndërtimeve dhe lidhjet e reja në rrjetin e transmetimit

ASETET E SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË SHQIPËRI

Sistemi Shqiptar i Transmetimit përbëhet nga: linjat e transmetimit, nënstationet dhe çdo element tjetër me nivel tensioni nga 110 kV deri në 400 kV.

Më poshtë janë listuar asetet kryesore të Sistemit të Transmetimit:

Numri	Tensioni	Tipi i Nënstationit	Njësia Operative
1	400 kV	N/St.400/220 kV, 840 MVA Tirana 2	Tiranë
2	400 kV	N/St.400/220 kV, 600 MVA Elbasan 2	Elbasan
3	400 kV	N/St.400/110 kV, 300 MVA Zemblak	Korçë
4	220 kV	N/St.220/110 kV, 540 MVA Vau i Dejës	Shkodër
5	220 kV	N/St.220/110 kV, 660 MVA Fierzë	Shkodër
6	220 kV	N/St.220/110 kV, 540 MVA Koman	Shkodër
7	220 kV	N/St.220/110 kV, 115 MVA Koplík	Shkodër
8	220 kV	N/St.220/110/20 kV, 486 MVA Tirana 1	Tiranë
9	220 kV	N/St.220/110 kV, 190 MVA Sharrë	Tiranë
10	220 kV	N/St.220/110 kV, 200 MVA Rrashbull	Tiranë
11	220 kV	N/St.220/110 kV, 360 MVA Fier	Fier
12	220 kV	N/St.220/110 kV, 200 MVA Babicë	Fier
13	220 kV	N/St.220/110 kV, 120 MVA Komsí	Burrel
14	220 kV	N/St.220/110 kV, 360 MVA Bradashesh	Elbasan
15	220 kV	N/St.220/110 kV, 360 MVA Bradashesh	Elbasan

Numri	Tensioni i linjës	Gjatësia në km
1	400 kV	445.091
2	220 kV	1159.6
3	150 kV	34.4
4	110 kV	1.658



Sistemi Elektroenergjetik Shqiptar operon në mënyrë sinkrone me zonën sinkrone të Evropës Kontinentale dhe lidhet me të nëpërmjet linjave të interkonjeksionit:

Linja 400 kV Tirana 2 - Podgoricë (M.ZI)

Linja 400 kV Zemblak - Kardia (GR)

Linja 220 kV Fierzë - Prizren (KS)

Linja 220 kV Kopluk - Podgoricë (M.ZI)

Linja 400 kV Tirana 2 - Kosova B (KS)

Linja 150 kV Bistricë - Myrtos (GR)

Garantimi i punës së sigurt të Sistemit Elektroenergjetik realizohet duke i kushtuar kujdes të veçantë mirëmbajtjes së rrjetit të transmetimit, detyrë që realizohet përmes bashkëveprimit të koordinuar të Njësive Operative me Njësinë e Mirëmbajtjes së Transmetimit, që ka në organikën e saj mjetet e rënda dhe specialistët e përgatitur, për ndërhyrje në raste kritike, ose që kërkojnë një profesionalizëm të lartë.

Gjithashtu, është e rëndësishme puna për ndjekjen në vazhdimësi të problemeve, avarive, mangësive që shfaq sistemi i transmetimit. Analiza e të dhënave në mënyrë konstante, na ndihmon për të programuar në kohë dhe me efektivitet ndërhyrjet e nevojshme. Për cilësinë e punës së Sistemit të Transmetimit janë me rëndësi planifikimet e remonteve, të cilat hartohen në bashkërendim me përdoruesit e rrjetit dhe kompanitë e transmetimit të rajonit. Plani i remonteve të pajisjeve primare të nënstacioneve, hartohet duke pasur parasysh informacionin e vazhdueshëm për pajisjet, të marrë nga personeli i mirëmbajtjes në Njësitë Operative, si dhe duke respektuar rekomandimet e manualeve të shfrytëzimit të tyre. Ndërsa për sa u takon linjave të tensionit të lartë, plani i remonteve hartohet duke u bazuar në informacionin periodik të ardhur nga sektorët e linjave në Njësitë Operative, dhe nga problematikat e dala në vitet e mëparshme.

Tabela e mëposhtme jep një pasqyrë të defekteve dhe avarive të Sistemit të Transmetimit, si dhe kohëzgjatjeve të eliminimit të tyre duke u përqendruar në linjat e transmetimit dhe pajisjet transformuese.

PASQYRA E STAKIMEVE TË LINJAVE PËR VITIN 2016

LLOJI I STAKIMIT

SHKAQET E STAKIMEVE

Emërtimi	Stakime gjithsej	Tranzitore	Qendrueshme	Kushte atmosferike	Difekt linje	Paisje primare	Mbrojtja	SHAM /SHAF	OSHEE, të tjerë	Të ndryshme	Kohëzgjatja
Linja 400kV	16	7	9	10	2	0	0	0	0	4	19h 15'
Linja 220kV	90	41	49	42	28	13	1	0	3	3	135h 10'
Linja 110kV	407	244	163	212	54	22	54	4	52	9	560h 20'
Totali	513	292	221	264	84	35	55	4	55	16	


PASQYRA E STAKIMEVE TË PAISJEVE PRIMARE PËR VITIN 2016

LLOJI I STAKIMIT


SHKAQET E STAKIMEVE

N/stacione	Stakime gjithsej	Tranzitore	Qendrueshme	Kushte atmosferike	Difekt linje	Paisje primare	Mbrojtja	SHAM /SHAF	Personel	Të ndryshme	Kohëzgjatja
AUTO, TR	35	9	26	5	6	13	9	0	0	2	79h 30'
Celsa TRR TT	5	0	5	0	0	5	0	0	0	0	18h 10'


STAKIME LINJASH




STAKIME PAJISJESH



Ndërprerjet në sistemin e transmetimit për remonte viti 2016



Avaritë në sistemin e transmetimit viti 2016



SISTEMI I MATJES

OST sh.a. ka të instaluar në të gjithë kufijtë e pronësisë me përdoruesit e rrjetit dhe në të gjitha linjat e interkonjeksionit një sistem matjeje sipas standardeve më të mira për kohën. Të dhënat e këtij sistemi matjeje përpunohen nga QME (Qendra e Menaxhimit të Energjisë) në kohë reale dhe ju dërgohen përdoruesve të rrjetit. Gjatë vitit 2016 u vu në zbatim dhe u punua me një projekt shumë të rëndësishëm (Rehabilitimi i Sistemit të Matjes), i cili plotëson të gjitha kërkesat e ENTSO-E, si dhe rrit sigurinë në matje.

Ky projekt pati zhvillim dhe përmirësim në drejtimet e mëposhtme:

a) QME (Qendra Menaxhuese e Energjisë)

Në këtë qendër, platforma e re (Hardware & Software) që është instaluar bën të mundur realizimin e një sistemi matjeje të hapur dhe me funksione të reja të teknologjive të avancuara të kohës, me aplikime në AMR, AMI, AMM dhe WEB. Ka një siguri të lartë në rrugët e komunikimit me matësit e energjisë dhe ruajtjen e të dhënave të tyre ndër vite.

b) Instalacionet e kryera në çdo pikë matjeje

Në çdo pikë matjeje është bërë dublimi i matësve ekzistues (referuar Kodit të Rrjetit). Kjo ka bërë të mundur testimin e njërit matës pa qenë nevoja e ndërprerjes së energjisë për këtë shërbim dhe rritjen e sigurisë.

c) Infrastruktura OPGW

Realizon komunikim më të sigurt, bazuar në rrjetin OPGW të OST sh.a.

SISTEMI I MBROJTJES RELE

OST sh.a. tregon një vëmendje të veçantë për mirëmbajtjen e Sistemeve të Mbrojtjes Rele nëpër objektet e Sistemit Energjetik Shqiptar, për të siguruar operim të vazhdueshëm, bazuar në kërkesat për sigurinë e lartë të Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar.

Politika e mirëmbajtjes konsiston në monitorimin e vazhdueshëm të sistemit të mbrojtjeve rele në vazhdimësi qoftë nga afër (qasje lokale) ose nga larg (qasje nga distanca), vlerësimin e gjendjes dhe mirëmbajtjen paraprake të tyre, për t'u siguruar që Sistemi Transmetues është gjithmonë i mbrojtur në mënyrë të përshtatshme, në përputhje me kërkesat e Kodit të Rrjetit të Transmetimit.

Veprimtaria e përmirësimit të sistemeve të Mbrojtjes Rele gjatë vitit 2016 ka qenë e përqendruar në:

- Mirëmbajtjen e sistemit të mbrojtjes rele në të gjitha nënstacionet 400kV dhe 220 kV të sistemit elektroenergjetik.
- Zhvillimin e sistemit të mbrojtjes rele në disa nënstacione të rëndësishme të sistemit, me objekt përmirësimin e skemave të mbrojtjes dhe të komandimit.
- Ndryshimet në konceptimin e sistemeve të mbrojtjeve rele, duke vënë në eficiencë mundësitë e mëdha të krijuara me instalimin e fibrave optike, pothuaj në të gjitha linjat e sistemit energjetik.
- Në këtë kuadër, po ndryshon shumë konceptimi i mbrojtjeve të linjave të Tensionit të Lartë (TL) dhe po rritet vazhdimisht përdorimi i mbrojtjeve diferenciale të linjave si mbrojtje kryesore në linjat 400 kV, 220 kV dhe 110 kV të sistemit energjetik.
- Trajnimin e specialistëve të mbrojtjes rele të grupit Qendror, si dhe të Njërive Operative.

SIGURIA NË PUNË

Aspekt shumë i rëndësishëm që ndiqet në mënyrë të vazhdueshme nga stafi OST sh.a. është siguria në punë dhe zbatimi i Rregullores së Sigurimit Teknik. Për vitin 2016, OST sh.a. kishte objektiva të përcaktuara në kuadër të rritjes së performancës për njohuritë e sigurimit teknik dhe zbatimin e tyre me përpikmëri në praktikë. Performanca e OST sh.a. në lidhje me sigurinë në punë është shumë e lartë, ku tregues për të është mospasja e asnjë të aksidentuari në punë.

RRJETI I TELEKOMUNIKACIONIT


Zhvillimet e shpejta të teknologjisë së telekomunikacionit kanë bërë të nevojshme përshtatjen e infrastrukturës ekzistuese të rrjetit të telekomunikacionit në përputhje me nevojat dhe kërkesat e kompanisë dhe të sistemit të transmetimit. Për këtë qëllim, OST sh.a. ka investuar në projekte të rëndësishme për rrjetin e telekomunikacionit. Këto projekte kanë për qëllim rritjen e sigurisë dhe performancës së komunikimit në sistemin e transmetimit.

➤ Zgjerimi i sistemit të telekomunikacionit

Në vitin 2016 u zbatua projekti mbi zgjerimin e rrjetit të telekomunikacionit që mundëson marrjen e të dhënave nga çdo matës energjie në të gjitha pikat e matjes së sistemit të transmetimit të OST të arritshme nga rrjeti ynë i telekomunikacionit. Me anë të këtij projekti është krijuar një rrjet i sigurt dhe i shpejt i marrjes së të dhënave nga pikat e matjes në Qendrën e Matjes së Energjisë. Në këtë mënyrë, komunikimi i matësve të energjisë mund të realizohet me anë të dy rrugëve redundante që janë: rrjeti i telekomunikacionit të OST dhe rrjeti mobil GSM/GPRS.

Sistemi i Monitorimit të Rrjetit Optik

- Një projekt i rëndësishëm për vitin 2016 dhe rrjetin e telekomunikacionit është dhe Sistemi i Monitorimit të Rrjetit Optik. Ky sistem ka si qëllim monitorimin në kohë reale të parametrave dhe komunikimit të rrjetit me fibra optike të OST. Me anë të këtij sistemi lokalizohet në kohë reale dhe me saktësi të lartë çdo defekt i mundshëm në linjat me fibra optike.



*SKEMA E RRJETIT TË TELEKOMUNIKACIONIT NË OST SH.A.

V. OPERATORI I TREGUT

OST sh.a. luan një rol të rëndësishëm si Operator i Tregut, funksionet e të cilit janë duke u zgjeruar gradualisht me hapat e përcaktuar për krijimin e një tregu të lirë dhe konkurrues të energjisë elektrike në Shqipëri, si dhe integrimin e tij në tregun rajonal të energjisë elektrike.

REGJISTRIMI I PJESËMARRËSVE TË TREGUT

Ky funksion lidhet me zbatimin e procedurave për regjistrimin e subjekteve që dëshirojnë të regjistrohen si palë në tregun shqiptar të energjisë, hartimin dhe administrimin e Regjistrimit të Palëve të tregut, me të dhënat përkatëse të subjekteve të regjistruara, si dhe plotësimin në vijimësi të kushteve përkatëse të tyre për të qëndruar palë në treg. Janë ndjekur në vijimësi të gjitha kërkesat e paraqitura nga subjektet, për t'u regjistruar në tregun e energjisë elektrike, në përputhje me licencat përkatëse të emetuara nga ERE.

Në fund të vitit 2016 rezultojnë të regjistruar 28 subjekte, zotërues të 49 licencave në treg, prej të cilëve:

- 18 janë Furnizues
- 23 janë Tregtues
- 8 janë Prodhues

Tregu shqiptar i energjisë elektrike, në përputhje me përcaktimet përkatëse të ligjit, rezulton në fund të vitit 2016 me 13 Konsumatorë të lidhur në Rrjetin e Transmetimit.

Referuar fundit të vitit pararendës, 2015, në fund të vitit 2016 rezultojnë me status “të pezulluar” në treg dy subjekte, për shkak se nuk kanë një Garanci Financiare të regjistrimit në OT brenda afatit të vlefshmërisë.

NJOFTIMI I KONTRATAVE

Të gjitha transaksionet e tregut shqiptar të energjisë, të rregulluara nga ERE ose jo, duhet të njoftohen në Operatorin e Tregut (OT), në formën e njoftimit të kontratave apo transfertave të aplikuara dhe pranuar të palëve të tregut. Është OT ai që cakton këto kontrata, certifikon vlefshmërinë e tyre, sipas procedurave përkatëse të fiksuara në Rregullat e Tregut.

Njoftimi i kontratave të transaksioneve në OT dhe regjistrimi në llogaritë përkatëse të palëve, është i nevojshëm, veç të tjerash, për trajtimin e përgjegjësive balancuese të palëve të tregut në transaksion.

OT administron një regjistër, në të cilin janë mbajtur llogaritë përkatëse të palëve, për transaksionet e njoftuara në OT.

Janë regjistruar në vijimësi të gjitha Njoftimet e Kontratave dhe transfertave të transaksioneve të palëve të tregut në shitjen, blerjen, importin dhe eksportin e energjisë elektrike.

NGA KY REGJISTËR REZULTON SE, TË NJOFTUARA NGA PALËT, JANË REGJISTRUAR:

Kontrata	Numri i kontratave	Volumi i energjisë (MWH)
Eksport	83	589,691
Import	73	1,089,598
Furnizim	56	502,981
Ndërmjet paleve	163	2,450,699
Total	375	4,632,969

ALOKIMI I KAPACITETEVE NË INTERKONJEKSIONE

OST administron kapacitetet transmetuese në interkonjeksione duke aplikuar rezervimin e të drejtës së transmetimit fizik nëpërmjet ankandeve, sipas Rregullave për alokimin e kapaciteteve në interkonjeksione. Janë regjistruar në vijimësi të drejtat e transmetimit fizik të palëve të tregut në interkonjeksione, sipas kufirit, drejtimit të fluksit dhe periudhës rezervuese, për të gjitha kapacitetet, vjetore dhe mujore, të fituara në ankandet e ATC të organizuara nga OST.

Në lidhje me alokimin e kapaciteteve në interkonjeksione, për vitin 2016 janë ndjekur procedurat përkatëse, sipas rregullave të miratuara nga ERE me Vendim Nr. 140, datë 22/11/2013 “Rregullore mbi alokimin e kapaciteteve në interkonjeksione”.

Tabela 1

Në Tabelën 1 janë përmbledhur disa nga të dhënat e ankandit mujor, për periudhën 1 janar deri 31 dhjetor të vitit 2016, të organizuara nga OST (Për interkonjeksionin Shqipëri - Kosovë).

OST	Interkonjeksioni Shqipëri - Kosovë (AL - KS) Alokim Mujor 2016												
	Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Nr. subjekteve pjesëmarrëse	Nr	7	6	7	9	7	8	5	9	6	7	5	9
Nr. Ofertave të pjesëmarrësve	Nr	53	50	55	173	106	70	36	66	72	97	47	61
Çmimi ankandit Euro/MWh	Exp Imp	0.01 3.03	0.02 0.51	0.19 0.03	0.19 0.15	0.12 0.16	0.15 0.25	0.01 0.13	0.05 1.25	0.05 0.38	0.08 1.09	0.20 0.08	0.59 0.06

Tabela 2

Në Tabelën 2 janë përmbledhur disa nga të dhënat e Ankandit Mujor, të organizuar për llogari të OST nga zyra rajonale SEE CAO, për interkonjeksionin me Malin e Zi”.

SEE CAO		Interkonjeksioni Shqiperi - Mali I Zi (AL - ME) Alokim Mujor 2016											
	Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Nr. subjekteve pjesmarrëse	Nr	10	11	12	12	11	10	11	12	13	10	11	14
Nr. Ofertave të pjesmarrësve	Nr	44	52	39	46	35	41	37	42	48	37	39	63
Çmimi ankandit Euro/MWh	Exp Imp	0.01 1.73	0.03 0.68	0.16 0.15	0.18 0.17	0.06 0.15	0.05 0.11	0.06 0.17	0.03 1.11	0.04 0.69	0.03 0.67	0.12 0.33	0.75 0.13

Tabela 3

Në Tabelën 3 janë përmbledhur disa nga të dhënat e Ankandit Mujor, të organizuar për llogari të OST, nga zyra rajonale SEE CAO, për interkonjeksionin me Greqinë.

SEE CAO		Interkonjeksioni Shqiperi - Greqi (AL - GR) Alokim Mujor 2016											
	Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Nr. subjekteve pjesmarrëse	Nr	14	14	14	15	13	13	14	14	13	12	14	16
Nr. Ofertave të pjesmarrësve	Nr	55	57	68	67	53	55	62	51	58	53	53	58
Çmimi ankandit Euro/MWh	Exp Imp	7.37 0.08	4.21 0.12	11.83 0.04	11.11 0.03	7.67 0.01	6.15 0.00	5.61 0.09	4.05 0.02	3.37 0.03	2.61 0.03	2.82 0.12	2.57 0.75

Tabela 4

Në Tabelën 4 janë përmbledhur disa nga të dhënat e Ankandit Vjetor, për periudhën 1 janar deri 31 dhjetor 2016, të organizuar për llogari të OST nga zyra rajonale SEE CAO, për interkonjeksionin me Malin e Zi dhe me Greqinë.

SEE CAO		Ankand Vjetor (1 Janar -31 Dhjetor) 2016								
	Kufiri	AL-ME		AL-KS		AL-GR		VLERA TOTALE		
	Drejtimi	Import	Eksport	Import	Eksport	Import	Eksport	Import	Eksport	Import + Eksport
Nr. subjekteve pjesmarrëse	Nr	12	11	-	-	14	15	26	26	52
Nr. Ofertave të pjesmarrësve	Nr	83	42	-	-	85	85	168	127	295
Çmimi ankandit (mesatar për OST)	Euro /MWh	2.07	0.07	-	-	0.19	7.52	1.13	3.80	2.46



*VENDET PJESËMARRËSE NË SEE-CAO

Duke vlerësuar se zbatimi i Tregut të energjisë është edhe një proces bashkëpunimi dhe i vlerësimit të ndërsjelltë ndërmjet OT dhe Pjesëmarrësve të Tregut, sipas rolit përkatës të tyre në tregun e energjisë, OT vijon kontaktet, takimet dhe konsultimet e herëpashershme me Pjesëmarrësit e Tregut.

Në total, janë alokuar në ankandet ditore 6,116 MWh nga të cilat 2,015 MWh pa konxhestion (ngushtësim), me një çmim mesatar të ofertave fituese me konxhestion, prej rreth 0.62 Euro/MWh, me vlerë totale 2,548 Euro.

Vlera totale e ankandëve të ATC të alokuara në ankandet ditore nga SEE CAO, për kufirin me Malin e Zi dhe Greqinë, përfshirë zbatimin e parimit “use it – or sell it” (“përdore ose shite”) nga pjesëmarrësit e tregut, është -19,330 Euro.

PJESËMARRJA NË GRUPET E PUNËS RAJONALE DHE INTEGRIMI RAJONAL DHE SHKËMBIMI I PËRVOJAVE ME OT-TË FQINJE

Sigurimi i platformës elektronike për operimin e Tregut mbetet prioritet i kërkesave për mbështetjen e punës së DOT, pasi do të shërbejë për rritjen në një nivel më bashkëkohor të komunikimit të Pjesëmarrësve të Tregut me OT, dhe do të rrisë volumet dhe cilësinë për informacionet e nevojshme për Operimin e Tregut në mënyrë korrekte dhe transparente, si dhe do të rrisë performancën e operimit të tregut dhe shmangien e gabimeve të mundshme në përlogaritje. Platforma në fjalë përgjatë vitit 2016 ka mundur vënien në punë të disa moduleve që lidhen kryesisht me planifikimin ndërkufitar. Modulet e tjera pritet të vihen në punë në fillim të vitit 2017.

Gjithashtu, kjo platforme do të mundësojë edhe kryerjen e funksioneve që aktualisht janë të pamundura për t'u kryer siç është realizimi i një tregu të hapur balancues dhe i blerjes së shërbimeve ndihmëse.

Specialistët e OT-së kanë marrë pjesë në grupet e punës për Krijimin e Bursës së Energjisë Elektrike, grup pune që kryesohet nga ana e MEI me pjesëmarrjen e OST-së dhe Sekretariatit të Energjisë së Vjenës. Grupi i punës, i ngritur me Urdhër të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë dhe në mbështetje të Modelit Shqiptar të Tregut, miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 519, date 13.07.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, ka përgatitur tashmë draftin e amendimeve në Ligjin e Sektorit Elektroenergjetik Shqiptar për t'i dhënë mundësi dhe për t'i hapur rrugë krijimit të Operatorit të Tregut që do të shërbejë edhe si Bursë e Energjisë Elektrike në Shqipëri e më gjerë.

Gjithashtu, janë hartuar nga ana e OT në bashkëpunim dhe me konsulentin e marre nga ana e MEI edhe Rregullat e tregut të energjisë elektrike, të cilat i janë përcjellë për miratim ERE-s në fund të vitit të kaluar dhe pritet miratimi i këtyre të fundit.

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar dhe takime të Grupit Rajonal të Evropës Juglindore (RG SEE), njëra prej të cilave u zhvillua në Tiranë nën organizimin e OST-së. Në këto takime, pjesë e të cilave janë edhe specialistët të OT-së, janë diskutuar çështje lidhur me ecurinë e rajonit, si dhe sfidat që nevojiten në të ardhmen për rajonin si ndaj bashkimit të tregjeve ashtu dhe ndaj zgjerimit të tij me vendet si Ukraina apo dhe Moldavia.

Po në këtë prizëm, është formuar dhe një Task Forcë e 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor, e cila do të ndihmojë Sekretariatit në përpilimin e raporteve periodike në kuadër të procesit të Berlinit, raportim i cili kryhet në baza tremujore dhe në të cilin përcaktohen ecuritë dhe angazhimet e ndërmarra nga ana e vendeve në drejtim të hapjes dhe bashkimit të tregjeve të rajonit me ato të Evropës Qendrore. Përgjatë vitit 2016 janë zhvilluar 2 takime të kësaj Task Force ku janë përcjellë mendimet e OST-ve lidhur me këto raportime.

Një detyrë e rëndësishme, e cila është zhvilluar edhe gjatë vitit 2016, ka qenë dhe nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit midis gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6) me iniciativë të Sekretariatit të Energjisë midis TSO-ve, Rregullatorëve, Ministrive dhe PX-ve të rajonit, në mbështetje të angazhimeve të marra nga ana e Qeverisë Shqiptare në procesin e Berlinit për bashkimin e tregjeve të vendeve tona. Detyrimi që rrjedh nga ky Memorandum Mirëkuptimi lidhet dhe me krijimin e Komitetit Drejtues të Bashkimit të tregjeve të një dite më parë me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të OT-së në të.

VI. PLANIFIKIMI I ZHVILLIMIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT

OST sh.a., mbështetur në ligjet në fuqi dhe në përputhje me kërkesat e ENTSO-E, harton planin afatgjatë të zhvillimit të Sistemit të Transmetimit, kryen llogaritje të cilat kanë si qëllim primar rritjen e performancës së Rrjetit të Transmetimit nëpërmjet planifikimit të ndërtimit të elementëve të rinj dhe fuqizimit të elementëve ekzistues të rrjetit.

Në përputhje me Kodin e Transmetimit dhe detyrave që dalin nga plani vjetor, lidhur me planifikimin e rrjetit, për vitin 2016, OST ka realizuar përpunimin e të dhënave të viteve të mëparshme si nxjerrjen e statistikave për vitin 2016 që lidhen me Konsumin dhe Humbjet sipas Rajoneve, konsumin vjetor për çdo nënstacion, Pikun e ngarkesës, Bilancin e Energjisë, stakimet në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2016, etj.

Të dhënat e sipërpërmendura janë të nevojshme dhe të domosdoshme për krijimin e modeleve dhe skenarëve të operimit të rrjetit për kryerjen e studimeve të nevojshme. Programi llogaritës i përdorur është PSS^oE (Power Transmission System Planning Software) për të cilën OST ka dy licenca.

Ndërtimi dhe përditësimi i modeleve të studimit të rrjetit i shërben analizës së detajuar të sistemit të transmetimit me qëllim evidentimin sa më të saktë të konxhestioneve me të cilat mund të përballet rrjeti dhe sistemi në tërësi. Pas analizave të regjimeve të ndryshme, nxirren rezultatet të cilat i shërbejnë planifikimit të detajuar të sistemit të transmetimit në të ardhmen.

Gjatë pjesës së parë të vitit 2016 është bërë finalizimi i Master-Planit 10-vjeçar të Zhvillimit të rrjetit të transmetimit deri në vitin 2025. Puna për realizimin e këtij plani zhvillimor ka filluar në pjesën e dytë të vitit 2015, dhe për këtë është kryer analizë e detajuar e sistemit të transmetimit duke bërë:

- Llogaritje të flukseve të fuqisë për të gjithë sistemin e transmetimit për regjimet bazë për vitin 2014 dhe viti 2025 është marrë viti objekt i analizës. Për këtë është bërë parashikimi i ngarkesës së sistemit deri në vitin 2025 dhe bazuar në aplikimet për lidhje me rrjetin e transmetimit është bërë parashikimi i gjenerimit. Për këtë të fundit është bërë vlerësimi i mundësisë së vënies në operim deri në vitin 2025 të këtyre centraleve;
- Vlerësimin e kriterëve të sigurisë së operimit të sistemit në kushtet e daljes nga operimi i një ose disa elementeve.
- Janë kryer llogaritje të flukseve të fuqisë për analizën e rajoneve të veçanta të sistemit të transmetimit. Këto llogaritje janë të nevojshme për kryerjen e fuqizimeve në pika të veçuara të rrjetit;
- Llogaritje të rrymave të lidhjeve të shkurtra për regjimet bazë 2014 dhe 2025;
- Llogaritje për vlerësimin e qëndrueshmërisë dinamike të sistemit elektroenergjetik.

Si pjesë integrale e punës, gjatë vitit 2016 janë realizuar disa studime, ndër më kryesoret përmendim:

- Studimi mbi mundësinë e instalimit të një shunt-reaktori në nënstacionin 400/110 kV Zemblak.
- Studimi për vlerësimin e zgjerimit të nënstacionit të HEC Koman për vendosjen e një transformimi 400/220 kV, si hyrje-dalje në linjën 400 kV të interkonjeksionit Tirana 2 – Kosova B dhe kryerja e llogaritjeve për mundësinë e vendosjes së një Shift-Transformer 400 kV.
- Studimi mbi mundësinë e operimit në paralel të linjës 150 kV Bistrica1 – Myrtos dhe fuqizimin e nënstacionit Bistrica 1 me një transformator me fuqi 80 MVA, transformatori ekzistues është 40 MVA.
- Llogaritje për mundësinë e ndërtimit të linjës me dy qarqe Elbasan2 – Fier me 2 nivele tensioni. Njëri qark i linjës parashikohet me nivel tensioni 400 kV, në perspektivë të ndërtimit të Nënstacionit 400 kV Kuçovë. Ky nënstacion do të shërbejë si një e rëndësishme për transmetimin e energjisë së prodhuar nga Termocentralet e parashikuara për t'u vënë në operim në Master-Planin e Gazit dhe qarku tjetër parashikohet me nivel tensioni 220 kV nga Elbasan2 në Fier direkt.
- Studimi i mundësisë së fuqizimit të Zonës Verilindore duke marrë në konsideratë burimet e reja që janë lidhur dhe parashikohet të lidhen në këtë zonë.

Studime me kërkesë të OSHEE:

- Llogaritje për mundësinë e lidhjes së një nënstacioni të ri 110/20 kV në Kombinat.
- Llogaritje për vlerësimin e shpërndarjes së ngarkesës në N/St 110/20 kV Qendër, për shkak të zhvendosjes së tij.
- Studimi i mundësisë së ndërtimit të një linje të dytë që të furnizojë Nënstacionin 110/20 kV Qendër.
- Procesi i vlerësimit të integritetit me rrjetin e transmetimit të Burimeve të reja Gjeneruese të Energjisë Elektrike.

Për sa i përket procedurave të lidhjeve të reja, si dhe statusit të aplikimeve për lidhje me rrjetin e transmetimit, gjatë vitit 2016 ka pasur një sërë aplikimesh që lidhen me mundësinë e lidhjes së centraleve konsumatore dhe prodhuese të energjisë elektrike, të shpërndara në rajone të ndryshme të sistemit Elektroenergjetik, siç paraqiten më poshtë:

- Centrale të tipit “Ngarkesë”, 2 aplikime, fuqia totale e kërkuar 30.4 MW, realizuar 1 Marrëveshje lidhjeje.
- Centrale të tipit “Gjenerues Hidrik”, 14 aplikime, fuqia totale e kërkuar 225 MW, realizuar 4 Marrëveshje lidhjeje.
- Centrale të tipit “Gjenerues Solar”, 6 aplikime, fuqia totale e kërkuar 122 MW, realizuar 1 Marrëveshje lidhjeje.
- Centrale të tipit “Gjenerues Eolik”, 1 aplikim, fuqia totale e kërkuar 30 MW, nuk është realizuar asnjë Marrëveshje lidhjeje.

Vitet e fundit janë vënë në operim mjaft burime të reja gjeneruese, kryesisht centrale hidrike ku një pjesë e mirë janë lidhur në rrjetin e transmetimit 110 kV dhe 220 kV. Në vijim jepet lista e centraleve të vënë në punë gjatë vitit 2016:

- HEC Tërnovë, 9.35 MW, lidhur në linjën 110 kV Bulqizë-Gjoricë
- HEC Malla, 6 MW, lidhur në Nënstacionin 110/TM kV HEC Lurë
- HEC Rapun 3/4, 11.35 MW, lidhur në Linjën 110 kV Fibër-Librazhd
- HEC Banjë, 71.5 MW, lidhur në zbarat 110 kV të Nënstacionit 110/TM kV Cërrik
- HEC Prellë, 14.9 MW, lidhur në zbarat 110 kV të Nënstacionit 110/TM kV Shutri.

Fuqia totale e instaluar e centraleve të lidhur përgjatë vitit 2016 në rrjetin e transmetimit rezulton të jetë rreth 113 MW. Kërkesat për lidhjen e burimeve të reja të prodhimit të energjisë elektrike në sistemin e transmetimit janë shtuar dhe sipas parashikimeve pritet që gjatë vitit 2017, por edhe në vitet e ardhshme, do të fillohet puna për ndërtimin e burimeve të rëndësishme të energjisë elektrike, kryesisht HEC-e, por edhe impiante fotovoltaike dhe centrale eolike.

PROJEKTET KRYESORE TË REALIZUARA GJATË VITIT 2016

a) Përforcimi i rrjetit të transmetimit 110 kV i Jugut të Shqipërisë.

Projekti ka vijuar gjatë vitit 2016 me:

- Zbatimin e kontratës për ndërtimin e zgjatime të linjave 110 kV, drejt Nënstacioneve Orikum dhe Himarë.
- Përfundimin e procedurës së tenderimit dhe nënshkrimit të kontratës për Ndërtimin e Nënstacioneve Orikum dhe Himarë (të cilat në përfundim të projektit do t'i transferohen si aset Operatorit të Shpërndarjes).
- Kontrata ka hyrë në fuqi më 30.12.2016 dhe përfundon pas 14 muajsh.

b) Linjë e re 110 kV me dy qarqe Rrashbull - Kavajë.

Projekti financohet me fondet e OST sh.a. 2.2 mil. Euro dhe përfshin:

- Ndërtimin e linjës së re ajrore me dy qarqe 110 kV Rrashbull – Golem - Kavajë, 19 km;
- Përcjellësi i linjës do të jetë material Alumin/Çelik me seksion 240/4 mm², ku fillimisht do të plotësohet vetëm një qark i linjës. Punimet kanë përfunduar dhe linja është në operim.

PROJEKTET NË PROCES ZBATIMI

a) Linja e interkonjeksionit 400 kV Shqipëri – Kosovë.

Projekti është një investim i Qeverisë Gjermane, financuar nga Banka KfW, 42 mil. Euro, ku pjesa shqiptare dhe përfshin:

- Zgjerimin e nënstacionit Tirana2 dhe instalimin e një Shunt-Reaktori 120MVA;
- Ndërtimin e linjës së re ajrore 400kV Tirana 2 – Kosova B.
Gjatësia e plotë e linjës është 242 km. Pjesa që kalon në territorin shqiptar është 151.5 km, ku 80 km e parë përfshijnë plotësimin e qarkut të dytë të linjës Tiranë-Podgoricë, nga Tirana në Laç Qyrfaq dhe 71,5 km linjë e re me një qark deri në kufi. Projekti është finalizuar me sukses në përputhje me parashikimet kontraktuale.

b) Zgjerimi 400 kV i N/stacionit të Komanit

Në kuadër të Kredisë dhe Projektit “Linja e Interkonjeksionit 400 kV Shqipëri – Kosovë”, me vlerë 42 ml Euro, ka një vlerë të mbetur të papërdorur prej rreth 7 ml Euro.

Në përputhje me sa parashikohet në marrëveshjen e kredisë dhe projektit (I. Plani i projektit, 1. Hollësitë e projektit), vlera e mbetur e papërdorur nga projekti do të investohet për zgjerimin e mëtejshëm të projektit të Linjës 400 kV Tiranë-Prishtinë me Zgjerimin e Nënstacionit të Komanit me një transformator të ri 400/220 kV.

Studimi për këtë komponent është kryer nga konsulenti INTEC-Gopa, i kontraktuar për projektin.

Ky studim konsiston në shfrytëzimin sa më optimal të rrjetit 400 kV dhe 220 kV nëpërmjet balancimit të flukseve të fuqisë dhe do të japë mundësinë e lidhjes direkt në rrjetin 400 kV, të dy agregateve në HEC Koman. Gjithashtu, investimi do të çojë në uljen e humbjeve të fuqisë, sidomos në rrjetin 220 kV, ku ato janë mjaft të larta.

Ndikimi është i dukshëm kur ka gjenerim të lartë të Kaskadës dhe në rastin më të mirë, humbjet e fuqisë ulen me 6.4 MW. Gjithashtu, sipas llogaritjeve reduktimi i humbjeve të energjisë do të jetë mesatarisht 8 milionë kWh në vit. Studimi i kryer, shpreh fizibilitetin e zbatimit të këtij projekti dhe ndikimin pozitiv që do t'i sjellë sistemit të transmetimit.

Kostoja e përgjithshme e parashikuar sipas studimit, për Zgjerimin e Nënstacionit të Komanit me një transformator të ri 400/220 kV, është afërsisht 10 milionë Euro.

c) Linjë e re 110 kV me dy qarqe Ulëz-Skuraj

Projekti financohet me fondet e OST sh.a., 0.95 mil. Euro dhe përfshin:

- Ndërtimin e linjës së re ajrore me dy qarqe 110 kV Ulëz-Shkopet-Skuraj, 8.7 km;
- Përcjellësi i linjës do të jetë material Alumin/Çelik me seksion ACSR-240/40 mm², dhe linja do të plotësohet me të dy qarqet.

Projekti është në fazë zbatimi dhe linja parashikohet të vihet në operim brenda vitit 2016. Pjesa Ulëz-Shkopet ka përfunduar dhe është në punë. Në pjesën Ulëz-Shkopet, Projekti është në fazë zbatimi dhe linja parashikohet të vihet në operim brenda vitit 2017.

d) Instalimi i dy Autotransformatorëve të rinj 60 MVA në Nënstacionin e Burrelit

Projekti financohet me fondet e OST sh.a., 1.7 mil Euro dhe përfshin:

- Instalimin e dy Autotransformatorëve të rinj 220/110/10 kV me fuqi 60 MVA secili;
- Autotransformatorët e rinj do të kenë të instaluar Rregullatorët Automatikë të Tensionit në ngarkesë dhe përshtjellë terciare me tension 10 kV për furnizimin e rajonit që përfshin qytetin, fshatrat dhe uzinën e Ferro-Kromit.

e) Instalimi i një Platforme Elektronike për Operimin e Sistemit dhe Operatorin e Tregut

- Projekti financohet me fondet e OST sh.a., 1.34 mil Euro dhe përfshin:
 - Instalimin e një platforme ku do të kryhen këto funksione kryesore:
 - Alokimi i kapaciteteve të linjave të interkonjeksionit
 - Njoftimet kontraktuale
 - Planifikimi i brendshëm dhe llogaritja e shkëmbimit ndërkufitar
 - Menaxhimi i të dhënave të energjisë
 - Arshivimi i të dhënave dhe raportimi
 - Mekanizmi i balancimit
 - Shërbimet ndihmëse
 - Shkëmbim i të dhënave direkte me platformën e transparencës së ENOST-E
- Projekti është në fazë zbatimi dhe Platforma Elektronike parashikohet të vihet në punë në vitin 2017.



PROJEKTE TË RËNDËSISHME PËR ZHVILLIMIN E SISTEMIT SHQIPTAR TË TRANSMETIMIT

a) Linja 220 kV me dy qarqe Tirana 2 - Rashbull dhe fuqizimi i nënstacionit të Rrashbullit.

Ky projekt përfshin:

- › Ndërtimin e një linjë të re 220 kV me dy qarqe, Tirana 2 - Rrashbull, rreth 18 km. dhe dy dalje linje të reja 220 kV në nënstacionet përkatëse.
- › Fuqizimin e nënstacionit 220/110 kV Rrashbull, 2x150 MVA.

PËRFITIMET:

- › Ky projekt është shumë i rëndësishëm për Sistemin Kombëtar të Transmetimit, sepse zgjidh probleme të tilla si: mbingarkimin e linjës ekzistuese, përmbushjen e kriterit të sigurisë N-1, uljen e humbjeve në transmetim dhe të energjisë së pafurnizuar;
- › Përmirëson furnizimin me energji elektrike në një rajon shumë të gjerë, që përfshin rrethin e Durrësit, Kavajës duke pasur një ndikim pozitiv në të gjithë zonën jugore të Shqipërisë;
- › Përmbush të gjitha kërkesat e legjislacionit shqiptar dhe evropian në lidhje me mbrojtjen e mjedisit;
- › Do të ketë një ndikim pozitiv në ekonominë e përgjithshme dhe në përmirësimin e mënyrës së jetës për popullsinë shqiptare;
- › Do të rrisë mundësitë për zhvillimin e mëtejshëm të turizmit pasi do të përmirësohet furnizimi me energji elektrike; Studimi i fizibilitetit të këtij projekti, financuar nga projektet WBIF, është përgatitur nga konsorciumi COWI / IPF. Projekti do të financohet nga Qeveria Gjermane, përmes Bankës KfW.

b) Përforcimi i rrjetit unazor 110 kV të Tiranës dhe ndërtimi i nënstacionit të ri 400/110 kV Tirana 3.

Ky projekt përfshin:

- › Ndërtimin e nënstacionit të ri 400/110 kV Tirana 3, 2x150 MVA.
- › Demontimin e linjave ajrore ekzistuese 110 kV Tirana 1 - U. Traktori, U. Traktori - Selitë, dhe ndërtimin e linjave të reja 110 kV (afërsisht 17 km. linjë ajrore me përcjellës ACSR-300 mm² dhe 7 km linjë kablore me përcjellës XLPE-1000 mm²).

PËRFITIMET:

- › Tranzitim të flukseve të energjisë nga rrjeti 400 kV i interkonjeksionit në rrjetin kombëtar 110 kV;
- › Rritje të sigurisë së operimit të sistemit;
- › Cilësi më e lartë e furnizimit me energji elektrike, si dhe rritja e besueshmërisë së furnizimit për rajonin e Tiranës;
- › Ulje të humbjeve në rrjetin e transmetimit;
- › Ulje të energjisë së pafurnizuar;
- › Projekti përmbush të gjitha kërkesat e legjislacionit shqiptar dhe atij evropian për mbrojtjen e mjedisit. Studimi i fizibilitetit të këtij projekti, financuar nga projektet WBIF, është përgatitur nga konsorciumi COWI/IPF. Projekti do të financohet nga Qeveria Gjermane, përmes Bankës KfW.

c) Linja e interkonjeksionit 400 kV Shqipëri – Maqedoni dhe zgjerimi i nënstacionit 400 kV Elbasan 2.

Ky projekt përfshin:

- › Ndërtimin e linjës së re ajrore 400 kV, Elbasan 2 - Bitola, afërsisht 151 km, 56 km të së cilës ndodhen në territorin shqiptar.
- › Zgjerimin e nënstacionit 400 kV Elbasan 2 me dy zbara dyfishe 400 kV, një dalje të re linjë 400 kV dhe një shunt-reaktor 120 MVA.

PËRFITIMET:

- › Zhvillimi i rrjetit ekzistues duke mbyllur unazën 400 kV ndërmjet Shqipërisë – Maqedonisë – Greqisë;
- › Përmirësimi i kapacitetit të rrjetit për t'iu përshtatur ngarkesës së parashikuar, dhe rritja e tranzitit, si dhe mundësia e lidhjes së gjeneruesve të rinj, duke përmirësuar kapacitetin transmetues në Shqipëri, Maqedoni, dhe në rajonin e Ballkanit në përgjithësi;
- › Përmirësimi i besueshmërisë së rrjetit rajonal, sigurisë së përgjithshme të furnizimit, dhe fleksibilitetit në operimin e

sistemit elektroenergjetik;

- Ulja e humbjeve në sistemin e transmetimit;
- Përmirësimi i cilësisë së furnizimit me energji elektrike (normalizimi i niveleve të tensionit, stabilizimi i shpërndarjes së flukseve të fuqisë dhe luhatjet e frekuencës, etj.);
- Mbështetja e zhvillimit të tregut rajonal të energjisë në Evropën Juglindore dhe krijimin e mundësive tregtare me Bullgarinë dhe Italinë;
- Mbështetje e ndërsjelltë midis Maqedonisë dhe Shqipërisë për shkak të diversitetit të gjenerimit të energjisë elektrike (Shqipëria-Hidro, Maqedonia- Termo);
- Ulja e kostos së sigurimit të kapaciteteve rezervë, si dhe ofrimi i mbështetjes reciproke emergjente. Studimi i fizibilitetit të këtij projekti, financuar nga projektet WBIF, është përgatitur nga konsorciumi COWI / IPF. OST dhe MEPSO (MK) kanë ngritur grupe të përbashkëta pune për ta ndjekur këtë projekt.

d) Linja e Transmetimit 400 kV Elbasan 2 - Fier

Rajoni i Fierit do të shndërrohet në një pikë shumë të rëndësishme për lidhjen në të ardhmen e burimeve të reja gjeneruese të energjisë elektrike, nga termocentralet me gaz. Ky projekt përfshin:

- Ndërtimin e linjës së re ajrore 400 kV, Elbasan 2 – Fier, rreth 74 km, si dhe dy dalje linje 400 kV në nënstacionin Elbasan 2 dhe nënstacionin Fier.
- Zgjerimin e nënstacionit 220 kV Fier, 1x400 MVA dhe lidhjen me rrjetin e transmetimit.

PËRFITIMET:

- Përmirësimi i standardeve të përgjithshme, besueshmërisë, cilësisë dhe efikasitetit të sistemit të transmetimit në zonën qendrore dhe jugore të Shqipërisë;
- Reduktimi i humbjeve në transmetim (ulja e kostos së furnizimit) në zonën qendrore dhe jugore të rrjetit 220 kV; Përmirësimi i cilësisë së shërbimit në aspektin ekonomik dhe shoqëror;
- Nxitja e zhvillimit ekonomik të rajonit qendror të Shqipërisë, si pasojë e furnizimit më të mirë me energji elektrike dhe uljes së kufizimeve të ngarkesës;
- Ulja e mbingarkimit të rrjetit 220 kV.

Studimi i fizibilitetit të projektit, të financuar në kuadrin e WBIF, është përgatitur nga konsorciumi Mott Mac Donald/ IPF. Për këtë projekt dhe atë të mësipërm, OST ka përfunduar fazën e marrëveshjes me Bankën Gjermane KfW, që ka shprehur interes në financimin e të dy projekteve (Linja e Interkonjeksionit 400 kV Fier-Elbasan dhe Elbasan-Kufi) në një paketë të përbashkët financiare. Komuniteti Evropian do të mundësojë një grant, si pjesë e këtij projekti.

VII. PASQYRAT FINANCIARE

OST sh.a. hartoi Pasqyrat Financiare për vitin 2016, të cilat u audituan nga një kompani auditi e pavarur (Grant Thornton shpk). Sipas raportit të lëshuar nga audituesit e pavarur, Pasqyrat Financiare paraqesin në mënyre të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar, performancën financiare dhe flukset e parase për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2016, në pajtim me Standardet Ndërkombetare të Raportimit Financiar duke mundësuar që opinionin i audituesve të jetë pa rezerva.

1. PASQYRAT E FITIMIT OSE HUMBYES PËR VITIN 2016

Shifrat e shprehura në Lekë	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
Të ardhura nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Të ardhura nga shërbimet e transmetimit	4,225,025,305	4,389,446,400
Të ardhura nga alokimet e kapaciteteve	1,489,053,307	1,703,543,127
Të ardhura të tjera	102,146,448	255,936,502
	5,816,225,060	6,348,926,029
Shpenzime për veprimtaritë e shfrytëzimit		
Shpenzime për materiale	103,434,970	101,430,227
Kosto transmetimi	583,733,603	513,574,919
Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	438,528,135	379,109,239
Shpenzime të personelit	1,013,470,116	1,020,193,973
Renia në vlerë, zhvleresimi dhe amortizimi	2,024,071,008	1,629,916,466
Humbje nga rënia në vlerë e aktiveve	-	1,456,785,573
Fitim/(Humbje) nga fshirje/ rënia në vlerë i të drejtave dhe detyrimeve	983,873	12,873,839
Total i shpenzimeve nga veprimtaritë e shfrytëzimit	4,162,253,959	5,113,884,236
Fitimi nga veprimtaritë e shfrytëzimit	1,653,971,101	1,235,041,793
Të ardhura financiare	210,575,802	256,655,513
Shpenzime interesi	761,761,775	289,642,144
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare, neto	551,185,973	32,986,631
Fitimi para tatimit	1,102,785,127	1,202,055,162
Shpenzimi i tatimit mbi fitimit	171,637,214	463,090,672
Shpenzimet/(të ardhurat) e tatimit të shtyre	3,628,968	497,178,146
Fitimi para tatimit	927,518,945	1,236,142,636



Të ardhurat përgjatë vitit 2016 janë realizuar nga transmetimi i energjisë elektrike për OSHEE sh.a dhe furnizuesit e kualifikuar, alokimi i kapaciteteve të interkonjeksionit dhe nga të ardhurat e tjera të ushtrimit të aktivitetit. Më poshtë po paraqesim të ardhurat mujore nga shërbimi i transmetimit dhe nga alokimi i kapaciteteve.

Shërbimi i transmetimit

- Të dhënat e faturimeve të shërbimit të transmetimit për OSHEE sh.a. dhe për klientët e tjerë, për vitin 2016, paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

TË ARDHURA NGA TARIFA E TRANSMETIMIT

TË ARDHURA NË BAZË MUJORE





Sherbimi i alokimit

- Në vijim, paraqesim një tabelë përmbljedhëse të faturimeve të bëra gjatë vitit për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve:


TË ARDHURA NGA ALOKIMI

TË ARDHURA NË BAZË MUJORE



2. PASQYRA E POZICIONIT FINANCIARE PËR VITIN 2016

Shifrat e shprehura në Lekë	31 dhjetor 2016	31 dhjetor 2015
AKTIVET		
Aktivitet afatgjata		
Aktive afatgjata materiale	51,834,208,965	50,943,268,701
Aktive afatgjata jomateriale	283,678,014	85,636,539
Aktive financiare afatgjata	14,495,878	15,201,308
Totali i aktiveve afatgjata	52,132,382,857	51,044,106,548
Aktivitet Afatshkurtra		
Inventari	655,032,642	711,041,461
Llogari të arkëtueshme dhe të tjera	9,311,517,588	9,549,572,564
Aktive financiare afatshkurtra	3,496,532	5,132,332
Tatim mbi fitimin i parapaguar	311,593,749	43,467,617
Parapagime dhe shpenzime të shtyra	183,134,208	190,661,127
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	225,812,564	612,673,151
Totali i aktiveve afatshkurtra	10,690,587,284	11,112,548,252
Totali i aktiveve	62,822,970,141	62,156,654,800
Kapitali neto dhe detyrimet		
Kapitali		
Kapitali aksionar	17,200,692,634	9,694,008,000
Rezerva ligjore	598,537,752	537,509,002
Rezerva rivlersimi	10,090,030,511	10,651,362,457
Rezerva të tjera	-	2,936,204,745
Fitime e pashpërndara	1,217,768,016	4,760,173,729
Totali i kapitalit neto	29,107,028,914	28,579,257,933
Detyrimet afatgjata		
Huate afatgjata	22,990,558,696	22,579,081,808
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	68,937,233	971,116,948
Grantet	593,718,886	620,113,880
Tatimi i shtyrë mbi fitimin	1,443,622,284	1,439,993,316
Totali i detyrimeve afatgjata	25,096,837,099	25,610,305,952
Detyrimet afatshkurtra		
Llogari të pagueshme tregtare dhe të tjera	3,056,359,716	3,377,538,767
Parapagimet nga klientë	48,590,844	203,921,167
Të ardhura të shtyra	62,651,247	55,817,499
Hua afatshkurtër	5,451,502,321	4,329,813,482
Totali i detyrimeve afatshkurtra	8,619,104,128	7,967,090,915
Totali i detyrimeve	33,715,941,227	33,577,396,867
Totali i kapitalit neto dhe pasiveve	62,822,970,141	62,156,654,800



Address: Autostrada Tiranë - Durrës, km 9
Yrshek, Kashar, Tirana, Albania
Tel.: +355 42 225 581, Fax: +355 42 225 581
E-mail: info@ost.al, web: www.ost.al